



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Urë Vajgurore, më ____ . ____ . 2024

**PROCES-VERBAL I ARGUMENTIMIT DHE MIRATIMIT TE SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Tipi i kontratës -SHERBIME

OBJEKTI I PROKURIMIT: “STUDIM PROJEKTIM LLINXHA FAZA E DYTË DHE PDV, ZONZ ZE3.3”.

Fondi limit: 4 166 666.67 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë.

Njësia e Prokurimit për procedurën në fjalë vendos që lloji i procedurës së prokurimit të jetë:
Procedurë e Hapur e thjeshtuar, sherbime.

Arsyet e përdorimit të procedurës - “ E hapur e thjeshtuar” është sepse vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 22114311-5 (Projekte).

Kriteret e përgjithshme të pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Dimal (Njësia e prokurimit) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar dhe nenit 26, 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas percaktimeve të vendosura në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe të veçanta të kualifikimit (shtojca 7).

Tek objekti i ekstratit të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit të jetë pasqyruar si objekt i veprimtarisë së tyre objekt i prokurimit.

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë vlerën 40% e fondit limit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatimit Taksave për xhiron vjetore të realizuar në tre vitet e fundit nga dita e shpalljes së kontratës.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3 e LPP, si dhe nenin 41, 43 pika 2 dhe 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore (2021, 2022 dhe 2023) është bërë bazuar në pikën 1, pikes 2 shkronja c, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, sipas së cilës “*Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*”.

Autoriteti kontraktor ka vendosur këte kriter pasi është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencen dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor duke provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përllogariturtë kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;
- c) **40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.**

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatuashme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2 Kopje të certifikuara të bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c të Ligjit nr. 10091/2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 10091/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese:

*"c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:***

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin, 2023, sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Bazuar në Nenin 26 pika 6 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, parashikohet se: “Perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, AK i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77 pika 3 e LPP, i ndryshuar, nenin 43 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Bazuar në Nenin 26 pika 6 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, parashikohet se: “Perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, AK i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

3. Kapaciteti teknik:

3.1 Shërbime të ngjashme të realizuara ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar *me institucione shtetërore*, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kesaj kontrate.
- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar *me subjekte private*, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, vërtetim për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kesaj kontrate".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, pikës 3 të nenit 41 si dhe të pikës 4 të nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë aftësitë teknike dhe profesionale që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" ku qartazi përcaktohet se: *"Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e perqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në

rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte. Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë profesionale për Projektim, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi) për këto kategori:

KATG. -1) PROJEKTIM URBANIST

c) Plane të detajuara vendore.

KATG. -2).PROJEKTUES ARKITEKT

d) Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

KATG. 3).PROJEKTUES KONSTRUKTOR

c-1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme - metalike

KATG. 4).PROJEKTUES INSTALATOR

a- Projektim të instalimeve hidrosanitare.

b- Projektim të instalimeve termoteknike – ventilimi - kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.

c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike-telefonike-citofoni-sistem alarmi-televiziv etj. për objekte civile e industriale.

f- Projektim të sistemeve kundra zjarrit.

g- Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndertesa.

i- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.

KATG 5).PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

b- Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.

c- Ujësjellës-kanalizime urbane - rurale.

KATG. 6. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

a) Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

KATG. 8).PROJEKTUES GJEODET

- Rivelime inxhinierike.
- Rilevime Inxhinierike Kadastrale

d) Bazamente gjeodezike.

KATG. 9). STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

d) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

e) Studime e projekte hidrogjeologjike.

KATG11). PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR.

- a) Projektim sinjalistike jondricuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime
- d) Projektim sinjalistike ndricuese në infrastrukture.

KATG. 12).STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

- c) Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Argumentimi: Në lidhje me vlefshmërinë e licencave ekzistuese dhe përshtatjen e kategorive me përshkrimet përkatëse, ofertuesit të mbajnë parasysht vendimin nr. 759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr. 943 datë 28.12.2016”.

(Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të bëjë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Autoritetit shteteror kompetent Shqiptar, konform VKM 759, date 12.11.2014, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016.)

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikes 4 te nenit 41 si dhe të pikës 4 të nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë aftësitë teknike dhe profesionale që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim** (lëshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licencave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

3.3 Operatori ekonomik për ekzekutimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të dëshmojë se ka të punësuar si pjesë të stafit si Drejtues Teknik vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale, CV dhe te jenë te perfshire ne listepagesen e shoqerise te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates:

- 2 (dy) Arkitekt
- 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik

- 1(një) Inxhiner Elektrik
- 1(një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8 ne DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterëve të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojcës nr. 9, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operoret ekonomik i kualifikuar fitues, duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetedeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetedeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar detyrës së projektimit pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

- Shërbimet për projektimin arkitektonik priten te kenë një volum te moderuar te projekteve qe realizohen për nivelin e objekteve dhe realizimit te peizazhit subjekt i kësaj procedure, si objekte te një kategorie te veçantë për te cilën gjykohet e nevojshme **Arkitekti** si staf teknik (arkitekthe godinash, peisazhi, etj).
- Punimet për shërbimin e projektit te infrastruktures se brendshme rrugore, shesheve, tretuareve dhe parkimeve kane gjithashtu një volum te rëndësishëm te cilat kërkojnë gjykim dhe punime te specializuara ne fushën e projektimit, si rrjedhoje gjykohet qe duhen **inxhinier ndërtimi**, pjese e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit hidroteknike do te jene një zë i rëndësishëm ne realizimin e projekteve qe parashikohen, si rrjedhojë gjykohet e nevojshme **inxhinieri hidroteknik** si pjese e stafit teknik
- Punimet për shërbimin e projektimit te sistemeve elektrike parashikohen bazuar ne termat e referencës, si rrjedhoje gjykohet e nevojshme prezenca **inxhinieri elektrik**, si pjese e stafit teknik.

- Punimet për studimin dhe vlerësimin gjeologjik do të jënë të pranishme kryesisht në vlerësimin gjeologjik për vlerësimin, si rrjedhojë gjykohet e nevojshme **një inxhinieri gjeolog** si staf teknik.
- Punimet për shërbimin e shtrimit telinjave të jashtme të furnizimit me ujë objekti, vaditje etj, si rrjedhojë gjykohet e nevojshme prezenca **inxhinieri mekanik**, si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit topografik do të jënë një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve që parashikohen të kenë dhe volume të konsiderueshme të punimeve topografike si rrjedhojë gjykohet që duhet inxhinier **gjeodet** si pjesë e stafit teknik.

Bazuar në Nenin 26 pika 6 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, parashikohet se: “Perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, AK i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

3.4 Staf mbështetës: Operatori ekonomik për ekzekutimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të dëshmojë se ka të punësuar si pjesë të stafit mbështetës:

- a) 1 (një) Inxhinier Ndertimi
- b) 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- c) 1 (një) Inxhinier Gjeodet
- d) 1 (një) Ekspert Mjedisi të pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- e) 1 (një) Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh
- f) 1 (një) Auditues energjie e Certifikuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë për të kryer auditime në ndërtesa dhe Instalime Industriale.

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Kontratat individuale të punës (të vlefshme), Diplomë, CV

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterëve të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 9, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar detyrës së projektimit, natyrës së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen. Meqenëse kemi të bëjmë me rikonstruksionin e disa objekteve, si dhe ndertimeve të reja, hartimin e PDV, dhe prezencën e stafit të mësipërm është gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme për një shpërndarje dhe efikasitet sa më të madh në realizimin e shërbimeve dhe konkretisht:

- a) Shërbimet për projektimin arkitektonik priten të kenë një volumin të moderuar të projekteve që realizohen për nivelin e objekteve dhe realizimit të peizazhit subjekt i kësaj procedure, si objekte të një kategorie të veçantë për të cilën gjykohet e nevojshme 1 (një) **Arkitekt** si staf ndimes (arkitekte godinash, peisazhi, etj).
- b) Punimet për shërbimin e projekteve të rrejtit rrugor, shesheve e parkimeve kanë gjithashtu një volum të rëndësishëm të cilat kërkojnë gjykim dhe punime të specializuara në fushën e projektimit, për të cilën kërkohet staf ndihmës. Si rrjedhojë gjykohet që duhet 1(një) **inxhinier ndërtimi** , pjese e stafit ndihmes.
- c) Punimet për shërbimin e projektimit hidroteknike do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve që parashikohen, si rrjedhojë gjykohet e nevojshme 1 (një) **inxhinieri hidroteknik** si pjese e e stafit ndihmes.
- d) Punimet për sistemet elektronike, kamera, telekomunikacion, si rrjedhojë gjykohet e nevojshme 1 (një) Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh si staf ndihmes.
- e) Punimet për shërbimin e projektimit topografik do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve që parashikohen të kenë dhe volume të konsiderueshme të punimeve topografike si rrjedhojë gjykohet e nevojshme 1 (një) **inxhinier gjeodet** si pjese e stafit ndihmes.
- f) Punimet për shërbimin e projektimit të Vleresimit të Ndikimit në Mjedis parashikohen bazuar në termat e referencës, si rrjedhojë gjykohet e nevojshme prezencën 1 (një) **ekspert mjedisi** , si pjese e stafit ndihmes.
- g) 1 (një) Auditues energjie e Certifikuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë për të kryer auditime në ndertesa dhe Instalime Industriale është i nevojshëm për hartimin e projektit të shkollës.

Bazuar në Nenin 26 pika 6 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, AK i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuesë të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

3.5 Operatori ekonomik duhet te disponoje punonjes te specializuar/ te kualifikuar, si me poshte:

1 (nje) punonjes i pajisur me certifikate si "Ekspert Privat Zjarrfikes" ne perputhje me klauzolat e ligjit nr.152/2015 date 21.12.2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin" shoqeruar me kontrate individuale pune te vlefshme, Diplome/certifikate si dhe duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit sipas shtojcës 8 ne DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar detyrës se projektimit, natyrës se përgjithshme te shërbimeve qe priten te ofrohen.

Bazuar ne Nenin 26 pika 6 e VKM nr. 285, date 19.05.2021, i ndryshuar, parashikohet se: “Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, AK i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumentave provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” te pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Stafi i kërkuar në pikën 3.3 dhe 3.4 dhe 3.5 të jetë i punësuar, për periudhën 3 muajt e fundit të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën te pakten 3 muajt e fundit.
- Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi per periudhën për periudhën te pakten 3 muajt e fundit.
- Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Diplomë, CV dhe te jenë te perfshire ne listepagese te pakten 3 muajt e fundit.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që

mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë:

Per percaktimin e fuqise punëtore minimale te kerkuar argumentojme se jemi bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas detyrës se projektit. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri i mësipërm përkon me stafin qe pritet te jete i angazhuar ne këto procedura.

Bazuar ne Nenin 26 pika 6 e VKM nr. 285, date 19.05.2021, i ndryshuar, parashikohet se: “Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit, AK i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumentave provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

3.6 Certifikata që duhet të këtë operatori ekonomik të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- a. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 45001:2018(e vlefshme) ose ekuivalente: Standardi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë;
- b. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 14001: 2015 (e vlefshme) ose ekuivalente: Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit, për florën dhe faunën;
- c. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 39001 - 2012 (e vlefshme) ose ekuivalente: Menaxhimi i sigurisë së trafikut rrugor;
- d. Shoqëria duhet te paraqesë certificate ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë.

Shënim: Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti

kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” si dhe QKL- te lëshuara nga institucionet shtetore perkatese.

Certifikatat e cilësisë janë bazuar ne përputhje me natyrën dhe objektin e kontrates qe prokurohet.

Operatoret e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë te certifikuara “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.(Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

Operatoret e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë te certifikuara “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.(Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

3.7 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qera:

1(nje) Pajisje GPS.

2(dy) Pajisje Total Station

1(nje) Dron Fotogrametrik

(Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Kontratë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar)

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4 të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 41, pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për përmbushjen me sukses te kontratës kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë qe ka ne disponim ose ne pronësi pajisjet topografike, pasi nevojiten për matjet dhe rilevimet topografike.

Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep

garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut.

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve dhe grafikut të punimeve pra verteton se ofertuesi i mundshëm zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë me anë të një deklaratë listën e personelit të nevojshëm që do të realizojë objektin e kontratës si dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

3.9 Bazuar në njoftimin e APP me nr. 5585 prot, datë 25.07.2017 “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe rekomandimit të APP me nr. 6559 prot, datë 27.06.2018, për llogaritjen e çmimit të ofertës së tyre, Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë parasysh sa më poshtë:

Vlera e ofruar duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Vlera limit (fondi limit), është vlera maksimale e llogaritur me vlerat e tarifave maksimale për grupin përkatës.

Të gjitha ofertat me vlerë më të lartë se vlera maksimale e lejuar, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 354, datë.11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, do të skualifikohen. Gjithashtu, të gjitha ofertat në vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar, e perlllogaritur mbi bazën e parashikimeve të VKM 354 në fjalë, do të skualifikohen.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT